



KRISTdimo





Krist Dimo spikat si artist me inteligjencë të shkëlqyer piktorike. Në thjeshtësinë e simboleve të tij, planet e shprehjeve mbeten për të "gjuha" e krijimit të një zhanri të fuqishëm. Të vëzhgosh veprat e tij, është si të udhëtosh në një "strabizëm emocional" që theksohet duke u fokusuar në linjat poetiko-emocionale të tregimit të tij për figura njerëzore të zgjedhura rastësisht në një shesh ose në rrugë, të çliruara nga gjërat e tepërta ekzistenciale. Jetë të jetuara në çrregullimin e palëvizshmërisë mortore, të ndarë nga lëvizshmëria e frymës, fytyra të frikësuar, fytyra të lënduara dhe të çorientuara, të buta nën vështrimet e engjëjve ujorë.

Kristi paraqet njerëzoren në qëmtimet e saj më të fshehta, duke përfaqësuar dyshimet e skëterrshme, zemërimet e pandryshueshme. Duke vëzhguar me kujdes veprat e tij, duket sikur i kthehesh në mënyrë magjike fëmijërisë. Etiketa të ngjitura në kënd njëra mbi tjetrën në derën e dollapit, në varrezat e kanibalëve gjigantë, që të kredhin në ëndërrime dhe të tërheqin në botën e dukurive të dhimbjeve pa arsye.

Ndonjëherë shqetësimi në to është arsye e qenies, ngjyra dhe linja të çartura, të vendosura në arkitekturën skajore të zdrukthëtarisë metalike. Burra ekstra-ujorë me sy si milingona që jetojnë në qoshtet e një bote të lodhur, që heshtjet shqetësuese i kufizojnë në forma. Të nxjerra nga kohët e vjetra të luleve dhe vazove që pozojnë në plastikë mbi kanavacën që po merr fund jashtë një kohe që mban erë merimangash.

Të humbur në ngjyrat e përhime që ndonjëherë i lë të jetojnë, me finesë kurajoze, në boshllëkun masiv të errësirës, mbështetur nga procedurat emocionale të shqetësimeve dhe në mospërputhjet e humorit, shpesh shfaqen sendërgjime bukurie inkurajuese. Në tiparet e shtigjeve stilistike të tij, gjithmonë programohen shformime formash që

hynë të gjalla në tunelet e të pandërgjegjshmes dhe dalin të rraskapitura nga dallgët ekzistenciale të baticës. Ka shfaqje hijesh të rraskapitura, rrezatuese në kupën e errët të qiellit. Gjigantë të zhveshur, të penguar në kthetrat e mjerimit të zemrës.

Krist Dimo u shton koncepteve poetike një kuturisje të prirur për një simetri bazike muzikore. Ajo na tërheq në hendeqet e historive të vërteta që përkojnë me bukurinë e asgjësë. Ai shpreh prozën e tij të thjeshtë, duke nisur një ngjyrë... ndonjëherë me tone të lehta dhe abstrakte, ndonjëherë me ngjyime të papajtueshme, të cilat lehtësojnë ndjekjen e linjave fizike ku dëshmohet estetika e mendimit të tij pikturor.



Ai na shoqëron përgjatë rrugës së tij artistike me një kumb snob që nuk i dorëzohet përzierjes në depon e zahireve të së kuqes me të verdhën dhe blunë e vendosjes në lindjen e diellit apo të së gjelbërës së luginave arkaike të kodrave malore.

Ai na paraqet fytyra udhëtuese që vdesin duke jetuar jashtë vetes, në një art të freskët të vënë në mur, duke e megjulluar pa pushim me martirizimin. Në një takim që përplot dhe lidh në linjat e përdredhura të vetvetes burrat që kundërshtojnë dëshirat themelore të bukurisë, zgjuarsinë helmuese që tmerron dhe tërheq.

Chieti 2018-2024

Carlo Colombo Calabria

Shkrimtar



Artisti befason me fillin linjë- formë duke krijuar një kontrast të veçantë midis qenies dhe "vakumit "së saj, çka është një ndjesi e tij. Krijimet e tij provokuese synojnë të na befasojnë, duke stiluar "hapësira intelektuale" që shfaqen në krijimin e "boshësisë" së formës njerëzore nga shprehja e paprecedentë e një mesazhi kompleks: "Zbrazëtia" si një limit tjetër i gjithë trupit që mund të përpunohet nga vetëdija jonë.

"Asgjëja e fundit" (2024) – Arti i Krist Dimo-s Rikthim tek Gjithësia e pandarë, tek e cila nuk ke qenë asnjëherë.

Qasja e parë e artistit është gjenerimi i një historie së cilës ai i përket, duke iu referuar perceptimit vetjak të realitetit, në krijimin e figurave të tij me copa të pabarabarta, duke deformuar kështu fizionominë e identitetit njerëzor, duke bashkuar e vendosur pjesët në një vakum të brendshëm që dimensionon strukturën origjinale skeletike që nuk ekziston. Thujse çdo njësi boshësie përcakton kufijtë strukturorë të njeriut në karakteret e tij unike.

Lindur në qytetin e Durrësit në vitin 1956, që herët shquhet për perceptimin e qartë të së ardhmes së tij artistike, duke nisur një rrugë individuale e cila rezulton vendimtare në formimin e tij poetiko-artistik. Vendosi të ndryshojë gjithçka, edhe këndvështrimin e tij akademik-artistik, duke përmbysur atë që mendonte shkolla për institucionalizimin e rrugëve edukative dhe krijuese të artistëve të ardhshëm. Të pikturonte faktet, ngjarjet që ndodhnin në realitet duke kapur shenjat e kohës, atë që çdo individ artist mund të kuptonte, nuk ishte me interes për të...



Të bësh art pa objekt do të thotë të heqësh shenjën e vërtetë të artit që kërkon qenia intime e shpirtit njerëzor, dhe kjo nuk i korrespondonte ndjenjës së tij. Çdo talenti i nevojiten vetëm disa të dhëna që të lëvizë dashurinë e tij drejt bukurisë dhe perceptimit të ndryshëm të realitetit.

Shpërngulja në Foggia të Italisë në Mars të vitit 1991, zgjoi tek Krist Dimo interesin e thellë për të kërkuar përtej njohurive si dhe për të ndërevepruar me kulturën italiane. I rëndësishëm në rritjen e tij artistike ishte takimi me maestro Dario Damato-n, drejtor i Akademisë së Arteve të Bukura në Foggia (nga viti 1988 deri 2000). Profesori ndjeu aftësitë artistike të Krist Dimos dhe e mori si student në laboratorin e tij artistik në Foggia.

Filloi kështu një udhëtim i ri artistik për të... "Nëse është e vërtetë që piktura nuk mund të jetë vetëm shprehje objektive" – siç u shpreh vetë Damato – është e vërtetë që brenda mundësive formale të pikturës së Krist Dimos, objekti ndëreveprues mund të identifikohet me "Boshësinë" e brendshme si përbërëse e vetë trupit; vend i pulsimeve emocionale dhe i mendimeve që nënkuptojnë identitetin e artit modern në forma të ndryshme estetike, që shprehet dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite. Arti i tij intrigon dhe bën pyetje, në dukje pa koncept, por kur i referohet diversitetit të parametrave poetiko-kulturorë të Italisë në fillimet e tij, duket se këto kanë kontribuar në përcaktimin e nivelit më të avancuar, të diçkaje të re në poetikën artistike të artistit. Që nga fillimi i kursit të tij në Laboratorin e mjeshtrit Damato ka zhvilluar poetikën në telajo me përmasa të mëdha, kompozime tiparesh imponuese, ku profilet e formave marrin një rëndësi vendimtare dhe ruajnë forcën shprehëse të veprës në universin e "vakumit" gjithmonë i pranishëm.



Gjatë vëzhgimit të veprave të tij artistike, i referohesh një arti që ka të bëjë me copëza pjesëzash anonime të pabarabarta, të fragmentuara dhe të bashkangjitura burimit numerik të artit, i cili ofron mundësinë e ndryshimit të konceptit të boshllëkut të brendshëm në identitetin e çdo individi si komponent kryesor i ekuilibrit dhe çon përsëri në zgjerimin e boshësisë ekzistenciale unifikuese në një funksion të krijuar nga dimensionin i çdo emocioni të pavetëdijshëm dhe primar të shpirtit njerëzor. Është e njëjta ndjesi që provohet në debulesën jo etike, në "boshllësinë" e energjisë së koshiençës. Duket sikur nuk ndjehet më nevoja e identitetit në qenien e plotë shkëputur nga boshësia e thellë origjinale e universit. Shkëputja me atë boshësi qëndron në themel të Misterit të "Unit" tonë në tërësinë e realitetit kalimtar. Arti i tij tregon "formën e zbrazët"; vuajtja e individit të bllokuar në mbërthimin ideologjik të maksimalizmit poetiko-artistik të shtetit duke nxjerrë në pah urgjencën e brendshme të identitetit të "Daljes". Shkëputja nga udhëzimet e një kulture të institucionalizuar në të gjitha artet dhe legalizuar në "Nihilizmin Shtetëror" kushtëzojnë vëmendjen ndaj artit të tij, i aftë të sinjalizojë kufijtë e mohimit të një "Uni" që nuk njih kufij për t'u përcaktuar dhe përmbushur në dëshirën për të bukurën.

Koncepti i "boshësisë" në veprat e artistit Krist Dimo është hapësira e brendshme, qendër kjo e gjendjes njerëzore si zonë e vëzhgimit të vetë ekzistencës, në kërkimin e një sensi.

Chieti 2018-2024


Carlo Colombo Calabria
Shkrimtar





2016

2024



Do të parapëlqejja të mos flisja për punët e mia, sepse nuk di si të shprehem me fjalë (të dija të shkruaja", thotë Edward Hooper", nuk do merresha me pikturë).

Të njohësh veten është gjëja më e vështirë dhe thuajse e pamundur, prandaj nuk e mendoj aspak atë që do të pikturoj.

Shpesh shfrytëzoj një njollë të bërë intuitivisht që përmban në vetvete diçka të çuditshme, jashtë arsyes dhe mundohem ta zhvilloj më tej. Në prekjen e fundme kuadri duhet të krijohet vetë, unë vetëm duhet ta finalizoj!

Ajo që më argëton më shumë është mënyra se si i jap formë jete diçkaje që krijohet spontanisht pa e menduar. Kjo prekje finale përmban në vetvete një energji të brendshme që më shumë më relakson. Është kjo energji relaksuese që më shtyn të pikturoj. Dhe kështu thjesht pikturoj, pa u menduar shumë.

Nëse "mendimi" merr përparësi, e shkatërroj atë që kam bërë dhe rifilloj nga e para, duke ruajtur ato gjurmë që i kanë "shpëtuar mendimit". Fundja arti nuk lind nga arsyeja, por nga "marria". Atë ti nuk e zotëron dot, ajo të drejton ty.

Duke e lënë atë të dalë jashtë teje dhe të të drejtojë, është më e mira që mund të bësh. Ajo vjen pa të lajmëruar, aftësia jote është ta pikasësh kur të vjen e ta lesh të lirë. Shpesh "mendimi" është më i lehtë për t'u kuptuar, prandaj jemi të prirur drejt tij dhe shpesh nuk e kuptojmë që kemi shkatërruar krijimin tonë!

Foggia - 2000

.....që pas 2000, më lindi dëshira të bëja një pikturë mbi të cilën çfarëdo "aksidenti" të ndodhte jo vetëm të mos ndikonte në të përgjithëshmen, por përkundrazi të shtonte praninë e "marrëzisë" mbi të. Dhe ne mjaft punë në fakt, nëse dikush zhgarravit me stilolaps apo gruas i derdhet vaji mbi të, nuk është se ndryshon gjë, në ndonjë rast mund edhe të ndikojë për më mire.

Tiranë - 2024

Krist Dimo

I would prefer not to talk about my work because I am not really good at putting words together. As Edward Hopper said, "If I knew how to write, I wouldn't be a painter."

Knowing oneself is the most difficult thing, almost impossible. That is why I rarely linger on the meaning of what I paint.

Instead, my process often begins with intuition, with a single spot on the canvas. A spot that contains within itself something mysterious, beyond reason, which I then further develop. With each brushstroke, the painting seems to come to life on its own.

What captivates me most is the act of creation itself: bringing order to chaos and giving shape to something not by thought, but by instinct. This energy, this surrender, is the true drive of my art.


I paint with little calculation. When thought takes the lead, it forces me to begin again, salvaging only the fragments untouched by logic. Art doesn't emerge from careful reasoning, but from a kind of beautiful madness—a force that cannot be possessed, only followed. It arrives with no warning; I simply recognize its presence and set it free. Thinking may offer clarity, but it often comes at the cost of authenticity. In trying to understand, we risk ruining what was already whole.

Foggia, Italy - 2000

Since the distant year of 2000, I've entertained a foolish desire: to create a painting so resilient that no accident could diminish it. On the contrary, every mishap—a scratch, a stray pen mark, a splash of cooking oil from your wife—would not mar the work but enhance its spirit, adding to its wildness. Maybe even perfecting it.

Tiranë, Albania - 2024

Krist Dimo





Inxhinieri mat kohën 2018 220X160CM AKRILIK NË KANAVACË

Fytyra e figurës qendrore është e bllokuar, e ndërtuar pothuajse si një mur me tulla. Kjo pasqyron një shkrirje simbolike të identitetit njerëzor me konceptin e një muri, që ndoshta përfaqëson barriera emocionale dhe psikologjike. Linjat e ngurta, pothuajse mekanike të fytyrës i bëjnë jehonë dehumanizimit dhe tjetërsimit në qendër të "The Wall" të Roger Waters - tema të shkëputjes, izolimit dhe murit metaforik të ndërtuar rreth psikikës së dikujt.

Sytë e ndezur ngjallin gjithashtu një cilësi spektrale, duke sugjeruar dikë të bllokuar brenda mendjes së tyre, të mpirë emocionalisht ose të burgosur.


Në kontekstin e Rënia e Murit të Berlinit simbolizoi jo vetëm lirinë politike, por shembjen e ndarjeve ideologjike, kulturore dhe psikologjike. Piktura kap momentin kur muret e jashtme shkërmoqen, por muret e brendshme mbeten për shumë njerëz.

Kjo vepër arti përdor një gjuhë vizuale minimaliste dhe të fortë bezdisëse për të përcjellë lidhjet me një moment historik të ndryshimit shoqëror, duke e bërë veprën si personale ashtu edhe kolektive në thellësinë e saj filozofike.
















Ushtrime të bukurisë 2018 220x160cm akrilik në kanavacë









Princi i vogël tha: Esencialja është e padukshme për sytë - në të njëjtën mënyrë, kur udhëtohet mes veprave të Kristit, midis të sikletshmes dhe të vrazhdës së qëllimshme, figurat zbehen dhe sytë ilënë hapësirë zemrës që dridhet dhe bëhet njësh me pafajësinë e këtij artisti. Pra Krist prek në atë pikë ku përftyrimi anulohet vetëvetiu dhe diçka e singertë, e vërtetë mbetet si një gjurmë e përherëshme në shpirt, aty ku melankonia, nostalgjia, naiviteti vallëzojnë së bashku nën dritën e Dashurisë.



Pritje e kotë 2018 110x160cm akrilik në kanavacë

Vështrim prekës 2020 110x160cm akrilik në kanavacë

Horizont i zbrazët 2016 100x140cm akrilik në kanavacë









Horizont i zbražet 2 2016 110x160cm akrylik ně kamavacě





Koha e memories 2019 110x160cm akrilik në kanavacë

Vështrim i ngrirë 2 2018 110x160cm akrilik në kanavacë

Dirigjenti 2017 140x160cm akrilik në kanavacë

Vështrim i ngjirë 2017 120x200cm akrilik në kanavacë







Ekzekutimi i përafërt dhe i papërpunuar i linjave të Kristit dhe përdorimi i ngjyrës të lë të kuptohet për primitivizëm - një përpjekje për t'u shkëputur nga format shumë të lëmuara, të idealizuara për të kapur një thelb njerëzor më instinktiv dhe të papërpunuar. Kjo mund të lidhet me dëshirën për t'u kthyer në diçka elementare, përtej kompleksitetit të jetës bashkëkohore.

Vetmia e Njeriut Mbret 2020 110x160cm akrilik në kanavacë

Model vështrimi 2024 110x160cm akrilik në kanavacë











Shprehjet naive dhe në dukje fëminore të personazheve të Kristit, asgjë nuk merret si shabllon, pasi në atë thjeshtësi të dukshme qëndron kompleksiteti i qënies njerëzore që me egon e tij kapriçioze kërkon hapësirë në botën përreth, shpesh i pasigurt dhe me frikë dhe ndonjëherë ndoshta me ligësi dhe dinakëri, por hapësira në të cilën ai përpiqet të futet është ajo hapësira boshe, por aq gjallë e Dashurisë, me të cilën ai kërkon kontakt, sepse është natyra e tij, që pret për t'u njohur.









Pikturat e Krisit shpesh përshkruajnë forma të shtrembëruara për të shprehur trazirat psikologjike, vuajtjet njerëzore dhe frikën ekzistenciale. Këtu, krahët e gjatë, qëndrimi i vështirë dhe busti joproporcional pasqyrojnë këtë ndjenjë të dislokimit dhe cenueshmërisë.

Koka e figurës, veçanërisht fytyra e zbehtë, e dehumanizuar me tipare minimaliste, abstrakte, të kujton fokusin e Krisit në shprehjet e shtrembëruara të fytyrës si një mënyrë për të përshkruar mundimin e brendshëm ose një vetvete të fragmentuar.

Kristi përdor shtrembërimin jo për realizëm, por për të përcjellë një gjendje më të thellë emocionale. Figura duket se është ngrirë në një pozicion të panatyrshëm, të ngurtë, duke dhënë një ndjenjë paralize psikologjike ose shqetësim. Tonet e mishit në fytyrë sugjerojnë mavijosje fizike ose tendosje emocionale për të përshkruar ashpërsinë e gjendjes njerëzore.


Duart, veçanërisht shenjat e dukshme të kuqe, të ngjashme me gishta, pjesërisht të ekspozuara, bëjnë gjeste në mënyrë shqetësuese. Ky ekspozim i lehtë i ashpërsisë është në kontrast me pozën e ngurtë të figurës, njësoj si ajo se si figurat neo-ekspresioniste shpesh luhaten midis kontrollit dhe kaosit.

Ngurtësia e figurës dhe sfondi i ftohtë dhe i sheshtë përforcojnë ndjenjën e të qenit të shkëputur nga bota, duke reflektuar shqetësimin e përbashkët me mënyrën se si bota moderne i largon individët nga identitetet e tyre.



Vakuum ekzistencial 2 2019 110x160cm akrylik ně kanaváčě









Pagjumēsia 2024 160x220cm akriliks nē kanavacē



Njeriu rosē 2024 100x120cm akriliks nē kanavacē







Forma e izoluar, abstrakte e figurës, e vendosur kundër një hapësire të zezësi boshësi, mund të evokojë tema ekzistenciale, dekonstrukcion postmodern, ku vihet në pikëpyetje uniteti i figurës njerëzore, duke simbolizuar identitete të thyera ose një kritikë të përfaqësimit tradicional – përballjen e individit me asgjënë dhe kërkimi i kuptimit në një botë kaotike ose të pakuptimtë.





Letra e fatit 2022 165x160cm akrilik në kanavacë









Portret i kuq 3 2020 100x120cm akrilik në kanavacë

Portret i kuq 2 2020 100x120cm akrilik në kanavacë






Udhëtim interstelar 2024 140x140cm akrilik në kanavacë




Pjesë ndërrimi për Robot 2024 100x120cm akrilik në kanavacë











Njeriu akuzon njeriun

Vepra e parë e grupit të vetëm në poetikën piktoreske të Krist, "Njeriu akuzon njeriun". Njeriu duket sa ka arritur në limitet e shprehjes së formës. Ai pret në vend të kësaj, në shumë figura të ndryshme përparësinë e konceptit të vetëm "Zbrazëtia e tretë e njeriut". Secila nga veprat e tij sinjalizon zbrazëtia e tretë, duke na befasuar në shprehjen e saj universale të formës njerëzore, ndjenja e ngjashme largëpamëse e të qenurit.

6





Vendimi i mjeshtrit 2024 100x120cm akrilik në kanavacë

Burra ekstra-ujorë me sy milingone 2020 100x120cm akrilik në kanavacë








Subjekt aktīvi iēvizies 2019 110x160cm akriliks uz kanavacē





Milingona 2018 220x160cm akrylik në kanavacë

Burra ekstra-ujorë me sy si milingona që jetojnë në qoshtet e një bote të lodhur, që heshtjet shqetësuese i kufizojnë në forma.

Të vëzhgosh veprat e tij, është si të udhëtosh në një strabizëm emocional që theksohet duke u fokusuar në linjat poetiko-emocionale të tregimit të tij për figura njerëzore të zgjedhura rastësisht në një shesh ose në rrugë, të çliruara nga gjërat e tepërta ekzistenciale.



Ekspozita e parë personale, Foggia, 1992
Në foto Prof. Dario Damato duke prezantuar ekspozitën.



Në studio, Siponto- Foggia

1991-2001

Lindur në qytetin e Durrësit në vitin 1956, që herët shquhet për perceptimin e qartë të së ardhmes së tij artistike, duke nisur një rrugë individuale e cila rezulton vendimtare në formimin e tij poetiko-artistik. Vendosi të ndryshojë gjithçka, edhe këndvështrimin e tij akademik-artistik, duke përmbysur atë që mendonte shkolla për institucionalizimin e rrugëve edukative dhe krijuese të artistëve të ardhshëm. Të pikturonte faktet, ngjarjet që ndodhnin në realitet duke kapur shenjat e kohës, atë që çdo individ artist mund të kuptonte, nuk ishte me interes për të...

Të bësh art pa objekt do të thotë të heqësh shenjën e vërtetë të artit që kërkon qenia intime e shpirtit njerëzor, dhe kjo nuk i korrespondonte ndjenjës së tij. Çdo talenti i nevojiten vetëm disa të dhëna që të lëvizë dashurinë e tij drejt bukurisë dhe perceptimit të ndryshëm të realitetit.

Shpërngulja në Foggia të Italisë në Mars të vitit 1991, zgjoi tek Krist Dimo interesin e thellë për të kërkuar përtej njohurive si dhe për të ndërvepruar me kulturën italiane. I rëndësishëm në ritjen e tij artistike ishte takimi me maestro Dario Damato-n, drejtor i Akademisë së Arteve të Bukura në Foggia (nga viti 1988 deri 2000). Profesori ndjeu aftësitë artistike të Krist Dimos dhe e mori si student në laboratorin e tij artistik në Foggia. Filloi kështu një udhëtim i ri artistik për të ... "Nëse është e vërtetë që piktura nuk mund të jetë vetëm shprehje objektive" – siç u shpreh vetë Damato – është e vërtetë që brenda mundësive formale të pikturës së Krist Dimos, objekti ndërveprues mund të identifikohet me "Boshësinë" e brendshme si përbërëse e vetë trupit; vend i pulsimeve emocionale dhe i mendimeve që nënkuptojnë identitetin e artit modern në forma të ndryshme estetike, që shprehet dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite. Arti i tij intrigon dhe bën pyetje, në dukje pa koncept, por kur i referohet diversitetit të parametrave poetiko-kulturorë të Italisë në fillimet e tij, duket se këto kanë kontribuar në përcaktimin e nivelit më të avancuar, të diçkaje të re në poetikën artistike të artistit.



kRiStdimo